

TALIA HIBBERT  
**OGUR NGA QIELLI, DANI BRAUN**

---

BOTIMET TOENA



TALIA HIBBERT

OGUR NGA QIELLI,  
DANI BRAUN

Përktheu nga origjinali anglisht  
Gjergji Kaftani

BOTIMET TOENA  
Tiranë

Autorja: Talia Hibbert  
Titulli në origjinal: Take a hint, Dani Brown  
Botoi në anglisht: HarperCollins Publishers

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Redaktore: Besa Vila  
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376848

© 2020, Talia Hibbert  
Botuar me marrëveshje me Avon, filial i HarperCollins Publishers.  
© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA  
Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë  
Tel.: + 355 4 22 40 116  
Email: botimet.toena@gmail.com  
toena.porosionline@gmail.com  
<https://toena.al>

*Për romantikët e pashpresë dhe për veten time*



## Shënim i autores

Mbani parasysh, ju lutem, që kjo histori ngërthen tema delikate, si përballja me vdekjen e pjesëtarëve të familjes dhe trajtimi i çrregullimeve të ankthit në përgjithësi. Shpresoj t'i kem cekur këto çështje me kujdesin që meritojnë.





## Prolog

art ndrinte hëna e plotë, nata dukej e volitshme për marifete shtrigash, kurse Danika Brauni kishte ngjyer me mjaltë aureolën e gjirit. Të majtin, për të qenë të saktë.

*Prapë u llangosa për dreq, mëmëriti dhe e fshiu.*

- Ia lëshuake frerët fantazisë në seancat e adhurimit, ë? Edhe këtë kishe mangët. - Shoqja më e mirë e saj, Sorka, vetëtitëse, me sy të shndritshëm gështenjë, bashkë të errët flokësh e buzëqeshje të anuar, u ul në anën tjetër të tryezës së vogël që u shërbente si altar.

- Nuk i dhashë krahë fantazisë, - murmuriu Dani, ndonëse pikërisht atë ishte duke bërë. - Gjinjve të mi u pëlqen të futin hundët kudo.

- Gjithmonë ky djall avazi me ty, - Sorka rrotulloi sytë dhe imitoi theksin e mprehtë të Danit, e saktë deri në detaj. - *Oh, ki mëshirë për mua dhe ballkonin tim si të rrallëkujt, edhe pse unë refuzoj me egoizëm t'ia fal qoftë dhe pjesërisht tjetër njeriu...*

- E po, s'ma do mendja se mund të ndajmë edhe indet e gjirit, Sork.

Sorka e kundroi me inat.

- Po të qe e mundur, do të më jepje nga të tutë?

- Aspak. Siç thua edhe vetë, ballkonin e kam si të rrallëkujt. Tani hesht dhe përqendrohu.

- Grua egoiste, djallëzore. Fyryfyçkë, me trurin sa një narcis i egër..., - kur vinte puna te natyra krijuese e fyerjeve, Sorkës mund t'i zije gjithmonë besë. Mërmërimat e saj të hareshme i mori era, teksa Dani hoqi mënjane kupën me mjaltë, kurse pjatën që kishte mbushur e la pranë mesit të tryezës. Mbas asaj pjate, vendosur shpinë më shpinë me Madonën e Zezë të Sorkës, qëndronte statuja e vogël e artë e perëndeshës Oshun.

Si çdo perëndeshë e dashurisë, e bukurisë dhe e bollëkut, që ka respekt për veten, Oshuni ishte mbuluar me bizhuteri e fare pak xhingla të tjera - nëse nuk marrim parasysh bletët dhe flokët gjer te beli. Ndërsa Dani kishte pak flokë, zero bletë dhe, zakonisht, nuk zhvishej në publik; nuk i kishte kushtuar kurrë vëmendje dashurisë romantike, sepse provat empirike e kishin dëshmuar si një shterje energjie që mund ta largonte nga objektivat me natyrë profesionale. Por fakti që Danit dhe Orishës nuk u përputheshin mendimet në lidhje me atë temë të caktuar, s'kishte dhe aq rëndësi; ajo statujë e artë qenkësh një kujtim i vyer që e kishte trashëguar nga e shtrenjta e saj, Nana e ndjerë, e njëjta grua që dikur i kishte thënë: *Forca e padiskutueshme e dijes kalon nga njëri brez te tjetri, s'ka rëndësi në vjen nga ata librat që lexon ti apo nga profecitë e një plake.*

Danika i kishte marrë të mirëqena ato fjalë. Për më tepër, ecja në gjurmët e mistershme të Nanës e kishte argëtuar e i kishte ardhur krejt natyrshëm. Mbase lidhej me ritualet dramatike të natës dhe me historinë e sfidës së paepur femërore.

- Fillo, pra, - i ra me bërryl Sorka, që me sa dukej, mbaroi së rendituri të metat e karakterit të Danit. Kësisoj, mbi

tryezën ku bënin hije dy idhuj të ndryshëm, në atë kthinë ku drita e qiririt dhe llamburitja e hënës së plotë kuvendonin ngeshëm, Danika i lidhi duart e veta me ato të shoqes, duke formuar kësisoj një rreth.

- Ti e para, - pëshpëriti Sorka.

- Oh, zemër, je e sigurt?

- Lëri lojërat. Unë e di që ty veç për paudhësi të punon mendja.

E tillë ishte Dani. Po bëhej një muaj qëkur i vuri kapakun lidhjes së saj të fundit, dhe aty rrëzë kofshëve merimanga kishte endur pëlhurën e vet (ai copëz vend qenkësh, për dreq, tokë pjellore për drama të tilla), dhe kjo lutje shpirtërore dukej se do t'i jepte fund, për fat të mirë, asaj gjendjeje të tmerrshme të krijuar prej ngjarjeve.

Ndaj dhe ajo u mbush me frymë dhe ia nisi:

*Përshëndetje, Oshun. Uroj që binjakët t'i kesh mirë. Këtë muaj, mendja më thotë se do të më përkrahësh në objektivin që i kam vënë vetes: më lypset një tjetër shok për seks.*

Sorka zgurdulloi sytë.

- Dale njëherë. Të duket ide e mirë kjo?

- Hesht ti, - ia preu Dani ashpër. - S'kam kohë të merrem me ty tani.

Sorka, duke qenë Sorka, ngulmoi sidoqoftë në të sajën:

- Më thoshte mendja se s'të kishte dalë ende inati me Xhonë.

Dani e përshkënditi me vështrim.

- S'kam qenë kurrë e inatosur me Xhonë. *Inati* renditet mes atyre emocioneve pa kuptim që të hanë kohën, ndaj edhe unë punoj fort që ta shmang.

- *Ashtu posi*. - Nga pohimi i tjetrës pikoi mosbesimi, njëlloj si pikonte dylli nga qirinjtë përreth. - Sepse unë isha gati të bëja be e rrufe që kur ajo të dha duart...

- Ajo nuk më dha duart. Thjesht donte të ndryshonte faktin që ne nuk ishim bashkë, kurse unë nuk doja.

- ... kur ajo të dha duart, - vijoi Sorka në të sajën, sepse e tillë kokëderre ishte Sorka, - ti bleve një kuti me miell për kek, i shtove një vezë dhe e kollofite të gjithën pa e pjekur fare, drejt e nga tasi i madh i vjetër...

- M'i do goja ëmbëlsirat, - ia preu Dani ftohtë, por fjalët e saj ishin fare të vërteta.

Sorka psherëtiu.

- Ti e ke të qartë që nuk është aspak e udhës për një shtrigë t'u qëndrojë larg ndjenjave të veta apo s'them mirë?

- Gjepura. Unë jam plotësisht në kontakt me ndjenjat e mia, të faleminderit shumë, Sork.

- Përveç rasteve kur nuk di si të sillesh me dikë, me të cilën ke shkuar në shtrat, por që pastaj bie në dashuri me ty, ndaj dhe zgjedh të kënaqesh me një *Betty Crocker*.

- *S'kishte të bënte me Xhozefinën*, - ngulmoi Dani në të sajën. - Me siguri më ka ndodhur në ditët para ciklit vajzëror apo diçka e tillë.

Ç'është e drejta, Danika Brauni nuk binte në dëshpërim - ose të paktën nuk dëshpërohej për marrëdhëniet ndërpersonale. Nuk ishte dëshpëruar qysh nga dita kur hyri dhe e gjeti dashurinë e saj të parë tek shfrente epsheet për kokërr të qejfit me tjetërkënd, dhe s'kishte për ta bërë ndonjëherë. Xhoja kërkonte romancë, mirëpo Dani ishte e mendimit se romanca nuk u përshtatej fare aftësive të saj,

ndaj dhe vajzat i dhanë fund miqësisë së privilegjuar duke i ndarë udhët e tyre dhe gjithçka ishte në rregull.

Përveç faktit që tanimë nuk i flisnin më shoqja-shoqes.

Përveç atij fakti.

- Boll u mundove të më nxjerrësh nga binarët, - foli Dani me vendosmëri, sepse dukej sheshit që e vetmja mënyrë për t'i dhënë fund kësaj bisede aq të urryer, ishte të mos lëshonte pe. - E di mirë çfarë po bëj dhe di po aq mirë çfarë dua. Jam grua e pjekur e me intelekt të arsyeshëm, në hullinë për t'u bërë titullare brenda pesëmbëdhjetë vjetëve pasues të jetës, me një dëshirë të pashuar për seks oral të shpeshtë dhe absolutisht asgjë tjetër. Ndaj hesht dhe më lër të kërkoj atë që dua.

- E po, si të ta marrë mendja, - ia priti Soroka qejfprishur.

- Mirë, atëherë. Kërkoje.

Dhe mrekullia ndodhi: ajo rrotulloi sytë, lëshoi një psherëtimë kundërshtimi, por në fund e qepi gojën.

*Si jo më mirë.* Njeriu lypset t'i shfrytëzojë, aty për aty, mrekullitë hyjnore.

Dani mbylli sytë dhe ia nisi sërish:

- Oshun, kam nevojë për një burim të rregullt orgazmash.

- Në mendje i erdhi Xhoja, ndaj shtoi: - Dikë që të mos presë prej meje më shumë nga ç'mund t'i jap. Brenda mundësive, dikë të ndjeshëm e me prapakolpin të kërcyer, të fokusuar te qëllimet vetjake. Unë nuk pata fat ta gjej vetë, ndaj nëse njih kënd që i përmbush këto kritere... ti thjesht... më drejto asaj ane. Më jep një pistë.

Kur i dha fund lutjes, ndjeu mbi vete një paqe të ngrohtë e të rrallë, si të atyre ujërave të lumit që i ka vakur dielli, a thua se perëndesha e kishte dëgjuar e i kishte premtuar të

bënte më të mirën. Nuk e fshehu buzëqeshjen e ndrojtur që ia lakoi buzët dhe u nginj në një heshtje të përflakur.

Por këtë të fundit e theu pa vonesë Sorka.

- O Perëndi, jo më kot i takon shenjës së Shigjetarit ti.

- Vrasje. Po bëhem gati të kryej një vrasje. - Dani hapi sytë dhe u ngrit në gjunjë, duke kundruar tryezën qetësisht. A duhej t'i jepte shoqes së ngushtë një të goditur në kokë me ikonën e shenjtë (mungesë e qenësishme respekti) apo me qiririn e rëndë prej dylli? Qiriri vazhdonte të digjej, ndaj lypsej të zgjidhte statujën. Vetëm se, kur zgjati dorën ta kapte, diçka i ra nga njëri prej xhepave të shumtë e të fshehtë të fustanit dhe vajti e goditi drejt e mbi altar.

Në fakt, gjësendi vajti e ra te këmbët e Oshunit, sikur ta kishte vendosur njeri me dorë mu mbi pjatën me mjaltë.

Dani e quajti si shenjë të një lloji të veçantë. Si ato që mbajnë mesazhe të tipit: *Të lutem, mos e vrit Sorkën, sepse do të pendohesh edhe vetë në fund dhe dua të besoj që burgu s'ka për të të shijuar.*

Sorka picërroi sytë në dritën e qirinjeve, pa u shqetësuar fare nga fakti që pothuaj u fërkua sup më sup me vdekjen.

- Prit, mos është kallam drithërash ai? Unë jam e pangopur.

- Është kallam proteinash, - e korrigjoi Dani, duke ia zgjatur.

- Qyshkur na ngrënke kallama proteinash ti? - pyeti Sorka, teksa thërrmijat u shpërndanë kur e theu mes gishtave, si barbare e patakt që ishte.

- Nuk i ha. Dikush ma dhuroi. Zot, Sork, je e vetmja që ngatërron gjithçka, kurse ne nuk i kemi mbaruar ende lutjet

tona. A s'deshe të luteshe dhe ti për atë konkursin e esesë krijuese, ku more pjesë?

- Kam frikë se s'do të më ndihmojë, - u skërmit Sorka. - Jemi dy shtriga të *ndyra*.

Dani tërhoqi hundët.

- Ti fol për veten tënde. *Unë* jam përqendruar tek e tashmja dhe i përshtatem magjisë së realitetit tim.

- Qëkur kështu ti?

- Qëkur bëra lutjen time, dhe tani jam në pritje të një shenje!

Sorka e flaku mbështjellësen e zbrazët të kallamit të proteinave në tryezë.

- Duke e ditur çfarë jemi unë e ti, gjasat janë që ta shohësh veç në ëndërr.





## Kreu i parë

*Pesë muaj më pas.*

**B**ari i Unionit Studentor ngjante me një këngë të keqe të muzikës pop: përsëritës gjer në dhimbje, gazmor gjer në çnatyrim. Qumështi ngrohej në avull, thirreshin emra dhe djemtë e banakut argaliseshin, a thua se kishin arsye për të tillë sjellje gazmore që nuk pëlqeheshin aspak. (Sigurisht që s'kishin fare arsye.) Dani ishte vonë për në punë, dielli i mëngjesit ishte jashtëzakonisht i ndritshëm, kurse zukama e kokrrizave të kafesë i shërbente si sfond i fantazive të veta për të vrarë gjithkënd që i ndodhej pranë.

Hollë-hollë, ajo e kishte shoshitur jo pak mendërisht tani së fundi punën e vrasjes. Ndoshta lypsej të kërkonte ndihmën e një profesionisti në lidhje me këtë që po i ndodhte ose ndoshta ishte thjesht pasoja e natyrshme e të jetuarit në planetin Tokë.

- Krisht, - mërmëriti Sorka, duke përzier një gjysmë kile sheqer në kafënë e saj me qumësht. - Gjithmonë kaq të zhurmshëm janë njerëzit këtu?

- Jemi në mars. Fundi i semestrit nuk është larg. Njerëzit janë... - Dani e la vështrimin të endej mbi gazmendin studentor që jehonte si rrallë tjetër herë gjithandej sallës, - *shpresëplotë.*

- Dikush duhet t'u japë këtyre ilaçin që u nevojitet. Është mungesë respekti në mëngjesin e së hënës.

Para se t'i jepte me gjithë zemër të drejtë shoqes së saj, një nga djemtë e banakut përplasi plot zhurmë dy kupat e kafesë që merren me vete.

- Çaj i jeshil dhe kafe e zezë për Danikën, ë?

- Të faleminderit. - Dani i rrëmbeu të dyja, ktheu krahët dhe u largua pa vonesë.

- Kafe e zezë, - murmuriu Sorka, ndërsa vajzat i bënë udhë vetes në masën e studentëve. - Kjo është për atë *bandillin* tënd të sigurisë apo e kam gabim?

- Bandilli ka emër.

- Dhe unë kam qejf ta thërras me sa më ha gryka.

Dani pothuaj u mbyt nga e qeshura që e kapi.

- Sorka, po ti je *lezbike*.

- Të faleminderit që e paske vënë re. Vërtet, Dani, këto janë thjesht llomotitje kafeneje. Po ç'tjetër mund të presësh nga ne vajzat? E që të kthehem tek ajo që nisa, ky është çasti ku ti pranon gjithë marifetet e ndyra që ta ka qejfi t'i provosh me atë gjoja shokun tënd Zafir.

Dani u ngrys kur dëgjoji atë emër dhe më së pari, sepse, po të mos ngrysej, mund t'i shpëtonte ndonjë buzëqeshje, të cilën Sorka do ta keqinterpretonte qëllimisht.

- Unë s'do të bëja kurrë marifete të ndyra me Zafirin. Është djalë për së mbari.

- *Për së mbari?* - Sorka e nxori fjalën si klithmë, me mosbesim. - *Zafi?* Zafir Ansari. Ai qelbaniku idhnak si gallof, që i kall datën gjysmës së godinës sate?

Dani rrufti çajin e saj jeshil.

- Për këdo që e njeh, ai është një tip fort i ëmbël.

- *I ëmbël the?* - timbri i zërit të saj desh theu edhe xhamin.

Mbase kishte të drejtë; *i ëmbël* mund të shihej si një cilësor që e mbivlerësonte djaloshin. Por Zafi ishte i sjellshëm, dhe Dani kishte pasur gjithmonë dobësi për tipat e sjellshëm: ishin mrekullisht të rrallë. Por ç'e do që Zafi mundohej të mos e mbërthente shikimin në gjoksin e Danit me atë përqendrimin si të Herkulit, që sugjeronte mungesë interesi ose tepri tiparesh kalorësiake, dhe Dani s'e honepste dot kalorësinë te një mashkull. Jo rrallë, prirja kalorësiake bënte që ata të merrnin vendime të gabuara, si fjala vjen, ta ftonin vajzën për darkë para se ta hidhnin në shtrat apo të rrinin e të lllomotisnin me të *pasi* kishin shijuar seksin.

- Zafi, sido që është i hatashëm, nuk hyn në listën time. Të thashë që jam në pritje të një shenje, - i kujtoi ajo Sorkës.  
- Por shtoj që s'kam kundërshtim të masturbohem duke pasur në mendje mjekrën e tij, derisa të më shfaqet shoku im i seksit.

Sorka i mendoj një hop fjalët e shoqes, mandej ngriti supet.

- S'e paske menduar keq. Po meqë erdhi fjala te bandillët që nuk na përshtaten, ke dëshirë të drekojmë bashkë më vonë në piceri? Është ajo kamerierja bombë që i pëlqejnë meshkujt.

- Nuk mundem. Do të punoj.

- Gjithmonë tregohesh një bushtër që...

Para se Sorka t'i jepte fund atij pohimi tejet të njëmendtë, udhën ua preu befas një burrë, si ai urithi që del nga dheu. Dani rrahu qepallat dhe mezi i mbajti këmbët.

- Oh! Më falni, - foli.

Burri u duk se nuk e dëgjoi. Vinte shtatlartë e flokëverdhe dhe kishte një buzëqeshje të shpenguar e të hijshme, që sikur pohonte se nuk ishte ndodhur kurrë para një kufiri, të cilin s'kishte mundur ta shembte. Dhe ja ku ishte prova:

- Mirëmëngjesi, - tha me zërin si të maçokut kur gërhin dhe sytë i mbërtheu mbi gjoksin e Danit, si ato raketat që për objektiv kanë dy malet binjake. - S'desha t'ju shqetësoj...

- E prapëseprapë, atë po bëni, - ia priti Sorka me të psherëtirë.

I gjati, Biondi dhe Karabushi i shpërfilli si trim fjalët e furacakes.

- ... por kur shoh një grua me të kuq të ndezur në buzë para orës nëntë të mëngjesit, - pasoi një shkelje syri, - hëm, them se kam për detyrë ta shpërblej.

Dani e këqyri një hop.

- Të më shpërbleni? Me çfarë? Se unë pranoj vetëm libra dhe ftesa restoranti.

Shkëndija e acarimit që iu end në fytyrë, donte të thoshte që *ndërrhyrja* e beftë e Danikës nuk qenkësh pjesë e skenarit të tij brilant. Por megjithatë, ai u kthye në hulli me një lehtësi të admirueshme.

- Ftesë restoranti, - tha me buzëqeshje, - më mirë herët se vonë, mjaft që ju të pranoni të darkoni me mua.

Dani tundi kokën me trishtim dhe u kthye nga Sorka.

- Ç'mendim ke ti, funksionon ndonjëherë ky marifet? Se lypset të funksionojë, a s'është ky kushti që ai dhe ajo të vijojnë më tej?

Sorka ia doli të injektonte një dozë të madhe neverie në një psherëtimë të vetme, aftësi kjo për të cilën Dani e kishte pasur gjithmonë zili.

- Ndoshta. Ose ndoshta, atyre thjesht nuk ua pret mendja të bëjnë lidhjen mes grave, të cilave u presin udhën dhe faktit që asnjë nga këto të fundit nuk i prek kurrë vullnetarisht.

Burri u shkund së brendshmi, ndërsa vetullën e drejtë ia rrudhi ngrysja.

- Prit njëherë, - nxitoi të thoshte, - mos i thatë për *mua* ato fjalë?

- Kuptohet vetiu që i thamë për ju, - ia priti Dani me të butë.

Biondi belbëzoi i indinjuar për ca sekonda, para se t'i këpuste një të sharë si flakërimë:

- Ik, moj dosë e fëlliqur! - shfryu dhe u largua si vrundull ere.

- Oh, e mjera, - psherëtiu Dani. - Sipas tij, qenkam një zuskë trashaluke. Nuk është çudi që mund të vdes, se ma bëri zemrën fërtele.

Sorka rrotulloi sytë.

\*\*\*

- *Çfarë po mendon?* - mërmëriti zëri në veshin e Zafir Ansarit.

- *Mendoj se të dua shumë.*

- *Atëherë, më zo...*

Zafi e ndali audiolibrin, duke ndërprerë kështu dhe zërin që buiste nga kufja e vetme. Ndonjëherë i jepej mundësia të lexonte teksa ishte duke punuar. Këtë herë, rasti nuk dukej i duhuri.

E hoqi nga veshi kufjen, e mbështolli rreth telefonit dhe i futi së bashku në xhep. Gjatë gjithë kohës nuk e ndau

vështrimin e mprehtë nga hyrja e ndërtesës Eko, dhe u vrenjt kur një djalë thatim, veshur me një si pizhame poshtë xhupit me kapuç, u rrek të hynte tinëz, pa e treguar fletëhyrjen si bënin gjithë të tjerët.

- Ej, ti! - Si shumica e fjalëve që thoshte, edhe këto i dolën si një buçimë inatçore. - Pa eja këtu!

Rioshi e ndali ecjen dhe ngriti t'i tregonte duart që, në fakt, i kishte të zëna me telefonin dhe... një kulaç.

- Nuk e arrij dot fletëhyrjen, - tha me ton shfajësues, dhe bëri të ecte tej, sikur ato fjalë ta kishin shpëtuar nga telashi i çastit.

- Eja këtu, të thashë! - përsëriti Zafi. Mandej u ngrit, veprim që i bënte njerëzit t'i vinin veshin, ngaqë dikur kishte luajtur si mbrojtës krahu në Ligën e Ragbisë.

I trembur, djaloshi kaloi pështymën poshtë dhe u qas te sporteli i sigurisë si ai qenushi kur e qortojnë.

- Tani, - foli Zafi i duruar, - pa vendosi këtu ato gjepogjërë që mban në duar.

Telefonin dhe kulaçin i uli në tryezë vetë ndjenja e fajit.

- Kaq e thjeshtë ishte, e sheh? Tani duart i lirove. - Pa harruar të kthente sytë nga hyrja, ku piku mëngjesor ishte davaritur në hyrje të rralla kur e kur, Zafi vijoi me ton urdhërues: - Fletëhyrjen!

Duke shfryrë e duke gulçuar, rioshi kontrollloi një mijë xhepa para se të gjente ku e kishte futur fletëhyrjen, gjë që do të thoshte se s'kishte hyrë në ndërtesë të çallatonte ndonjë kufomë ose të vidhte gaz shpërthyes.

- Do të bëhem vonë tani, - murmuriti, ndërkohë që po zgjaste fletëhyrjen.

- Nuk është problemi im, - Zafi e mori fletëhyrjen dhe e afroi te pajisja automatike e kontrollit në tryezë. - E di çfarë mund të bëj unë? Mund të detyroj edhe më të fundit syresh mes jush të vihet në rresht, ndërkohë që ju verifikoj njërin pas tjetrit në sistem. Por unë jam njeri i arsyeshëm. - Jo tërësisht e vërtetë, por fundja, as leshko s'i thoshe dot. - Ndaj kam zgjedhur të përdor shikimin. E lehtë për ju, e lehtë edhe për mua. Përveç rasteve kur nuk e mbani fletëhyrjen dukshëm që ta shoh. Atëherë, nuk është më dhe aq e lehtë puna, sepse unë s'e kam vështrimin me rreze X. Lërmë të të tregoj diçka. - Zafi e verifikoi kartën dhe e ngriti lart nga fjongoja e kaltër, stampuar me logon e universitetit. - Nuk e di ku vendoset kjo? E kanë bërë që të kalohet në qafë. Në këtë mënyrë, s'të duhet të zgjedhësh: të mbash kulaçin në dorë apo të më zemërosh mua. Të tingëllon bukur?

- Nuk mundem ta var në qafë, - mezi belbëzoi rioshi, - do të dukem si karabush.

- Ti ke veshur pizhame *Adventure Time* të shkosh në laborator, shoku. Dukesh që larg si karabush, do të ta thotë edhe profesori yt sapo të të shohë.

- Çfa... çfarë paskam bërë? - djaloshi uli sytë poshtë. - Oh, për të vënë duart në kokë.

- Eja këtu. - Zafi e kaloi fjongon mbi flokët e shprishura të djaloshit. - Hajt, marsh tani!

Me një vështrim inatçor e ca fjalë nën zë, djaloshi avulloi sakaq.

Mandej, nga e djathta e vet, Zafi dëgjoi një duartrokitje të përmbajtur e sarkastike, gjithë sa lypsej për t'i dhënë të kuptonte që mbesa e tij kishte hyrë në ndërtesë. Ai u kthye

ta vështronte, duke e braktisur aq shpejt sa munda humorin e keq që e kishte natyrë të përhershme.

- Qenushe! Çfarë bëke ti këtu?

Mbesa zgurdulloi sytë e ngjyer që ungji të ftillohej, mandej e ktheu kokën vrikthi nga grupi i vajzave që i rrinin pas.

Zafiri qëroi grykën dhe luftoi ngërçin e buzëve.

- Më fal, Fatima, dua të them. - Ai u tundi dorën vajzave prapa. - Mirëmëngjesi, shoqet e Fatimas.

- Do të qetësohesh tani? - pëshpëriti mbesa. - Po më bën të ndihem keq me shoqet.

- Unë synoja që të turpëroheshe. Lypset të provoj më fort.

Mbesa lëshoi një hungërimë si këlysh luani dhe u kthye të përshëndetej me shoqet.

- Shihemi lart, mirë? - Kur vajzat pohuan dhe u larguan, ajo u kthye sërish nga ungji. - Tani e kuptoj përse ke zgjedhur këtë punë. Të jep rast t'u hakërrehesh njerëzve e të thuash se e bën meqë të ka rënë në pjesë.

- Ëndërr e bërë realitet e ka emrin, - ia ktheu Zafi thatë dhe u ul. Vendosur poshtë e prapa sportelit të lartë të sigurisë, ishte tryeza që ai e përdorte për punë, dhe tani u mëshoi tasteve që në ekran të afishohej ora...

Nuk është se priste të shfaqej ndonjë person i veçantë. S'kishte as arsye më të vogël për ta bërë këtë.

- Më dukesh i lodhur, - po thoshte mbesa. - Mamaja mendon se ti rraskapitesh, por kur të plakesh do të pendohesh.

- Shtojë edhe këtë në listë. Dhe unë nuk dukem i lodhur, dukem i mistershëm.



- I mistershëm si një zombi, - plotësoi Fatima.

- Po sillesh si vajzë e prapë. Trego respekt për më të mëdhenjtë.

Ajo e kundroi me sy të picërruar, anoi kokën me tallje dhe broçkullisi si torollake:

- Të lutem, i shtrenjti Çaçë, fli tetë orë netëve, mos shkruaj letra bamirësie apo çfarëdo tjetër që zgjedh të bësh, dhe ndoshta s'do të ngjash si kufomë në punë, inshallah.

Mbesa s'i kishte lënë gjë mangët të atit. Mendimi ishte i hidhur e i ëmbël njëherazi.

- Do ta mendoj. Po ti, ç'kërkon këtu? S'ka ndodhur gjësend për t'u shqetësuar, ë?

Gjatë atyre muajve që Fatima kishte nisur studimet, Zafi e kishte parë rrallë e për mall në kampus, por gjithmonë nga larg. Aq mirë sa mundej, ai e kishte bërë të vetën rutinën e ungjit që vë në siklet mbesën dhe ajo zakonisht i përvidhej, duke lëshuar drejt tij ca vështrime që shponin si shigjeta - por ja tek ishte tani, në ngrehinën ku punonte i ungji. Ankthi erdhi e iu mblodh si xhungë në kraharor, përherë gati e në pritje të shpërthente. Rutina e Ungjit Mbrojtës i dukej edhe më intensive nga ajo e Ungjit që Ndillte Siklet.

Por Fatima rrotulloi sytë - po niste t'i bëhej shprehi ai marifet - dhe psherëtiu:

- Jo, Çaçë. Asgjë për t'u shqetësuar s'ka ndodhur. Thjesht kam ndërruar klasën, që t'i bëj vend vetes te gjuha panxhabe<sup>1</sup>, niveli i parë.

---

<sup>1</sup> Gjuhë indo-ariane, gjuha amtare e rajonit të Panxhabit, në kufi me Pakistanin.

Zafi harkoi vetullat.

- Gjuhën panxhabe e flet për mrekuulli.

- Pikërisht. Kam shpresë të dal në tabelën e nderit. Sigurisht, nuk e dija që seminari im i letërsisë ishte caktuar të zhvillohej në tjetër auditor, - vajza rrudhi hundën e brodhi shikimin në holl pa e fshehur hiç neverinë, - te *ky këtu*.

Ngrehina Eko dukej si e ulur galiç; relikti i përhirtë diku në gjysmë të udhës që të shpinte në universitet, ku studentët e mjekësisë kryenin praktikat e tyre të çuditshme mbi kufoma njerëzish e organe kafshësh.

- Oh, nuk është dhe aq keq, - ia ktheu ai buzagaz. - Më së paku, do të kesh rastin ta shohësh më shpesh ungjin tënd të parapëlqyer këtej e tutje.

- Unë të shoh ty pothuaj dita me ditë, dhe ti je *i vetmi* ungj që kam, - ia ktheu ajo me zë ankimtar dhe e kaloi çantën e dorës nga supi i majtë në të djathtin. Ai e kishte porositur një mijë herë të përdorte një çantë shpine, që pesha e librave të ndahej barabar, por mbesës rioshe ia kishte qejfi të ndiqte prirjet e modës së fundit, njëlloj si e ëma.

- Mund të qahesh sa të duash, Qenushe. Unë e di që ti më ke xhan. Tani nxito për në mësim, ndryshe do të arrish vonë.

- Po, gërnjar, po. Kështu ma paguan kur bëhem merak për shëndetin tënd, ë? - Me një tjetër spërdredhje të buzëve, vajza u kthye të largohej.

- Mbesë, - i thirri ai nga prapa, - bëhu vajzë e mbarë e më sill mëngjesin herën tjetër.

Ajo e shpërfilli, duke nxituar hapin teksa largohej.

- Qoftë dhe diçka sa për të shuar urinë. Qenushe! Më dëgjove?

Lëvizja e lehtë e shamisë së saj mbi sup shprehte atë të pathënën *s'më bëhet fare vonë për ty*.

Pastaj, Fatima humbi tej dhe Zafi ngeli vetëm - fakt që e bëri t'i kthehej sërish kompjuterit të vet. Sikur të ishte pakëz më i dhënë pas vajzave, mbase do ta kishte vënë re njërën që ishte vonuar, por ai s'ishte tip i tillë, ndaj dhe nuk ia kapi syri. Ndërkaq, fërkoj mjekrën e shkurtër, kërciti gjuhën pas dhëmbëve dhe i hodhi një sy postës së tij elektronike. Kishte mbërritur një si punë kujtese e orës së fundit nga shefi i personelit, në lidhje me manovrën e evakuimit të planifikuar për atë ditë, sepse ngrehina Eko strehonte me shumicë gaze të rrezikshme, ashtu si strehonte edhe organe të çuditshme. Ishte dhe një tjetër sosh, dërguar nga personeli i skuadrës së ragbisë së universitetit, ku e ftonin të luante... por, ndonëse atij i qante syri, ajo ishte punë me zarar. Kohët e fundit, atë me zor e njihnin, për shkak të mjekrës që kishte lënë, pa përmendur se po mbushej dekada qysh se kishte luajtur për herë të fundit si profesionist. Mirëpo, shfaqja e tij mes tifozëve vendas në fushën ku luhet ragbia, mund t'ia freskonte kujtesën dikujt, dhe nëse ky dikushi e pyeste *Ej, a nuk je ti ai tipi, familja e të cilit u përfshi në një aksident automobilistik?*, nuk ishte çudi që ai t'ia ngjeshte si pa dashur me grusht surratit.

E teksa e dërgoi në kosh me një psherëtimë, porta automatike e ngrehinës Eko u hap ngadalë. Në shikimin periferik iu regjistrua një figurë e njohur dhe ai pati ndjesinë se thellë brenda vetes diçka heshti. Ndenji në pritje. Ndjeu uri.

Kur u kthye, ja tek ishte Danika Brauni.

Ajo ecte sikur të mos ishte penguar kurrë, tek këqyrte hollin e zbrazët me ata sy si të felinit, në të cilët edhe atij sikur i qe bërë një djallo zakon të zhytej ca. Lëkura e saj e zeshkët flakëronte ëmbël nën të njëjtat drita fluoeshente që këdo tjetër e bënin t'i përngjante fantazmës, të sëmurit me verdhëz a ndonjë të irnosuri. Dhe megjithëse ai i kishte thënë vetes një mijë herë se lakmia që mund t'i lindte për një shoqe - një shoqe *pune* - një shoqe pune që nga pikëpamja seksuale mund të ishte dhe e orientuar ndryshe - ngjante ngjitëse në rastin më të mirë dhe ngjethëse në atë më të keqin, sërish e ndjeu epshin mbi vete si atë ndërhyrjen e dënueshme të lojtarit kundërshtar.

- Jam me vonesë, - vërejti Danika, sepse nuk e kishte zakon të thoshte tungjatjeta apo mirupafshim. Fustani i saj i gjatë e i zi, u vërtit si fluturidhë teksa po i afrohej atij, me pëlhurën e lirshme që rrallë e tek i ngjitej te kofshët, tek ijët apo te beli. Por ai nuk ia mbërtheu sytë, nuk i dukej e udhës.

- Ja tek e ke, - foli vajza dhe e shtyu kupën drejt tij në sportelin që i ndante. - Kafe e nxehtë sa më s'bëhet, e zezë po aq, e hidhur gjithaq, për princin tonë që rron në terr.

- Gëzuar princessë, - ia priti ai flakë për flakë, dhe u shpërblye me një buzëqeshje një milion dollarëshe nga goja e ëmbël kuq si gjaku. Ajo skenë i shkaktoi në damarë një krisje si të elektricitetit. Ai mori zemër: - Ke mallkuar ndonjë adoleshent kohët e fundit?

- Ke llahtaritur ndonjë plakaruqe kohët e fundit? - ia ktheu ajo ëmbël.

- Plakat më kanë xhan.

- Uh, uh, i ke përvëlur të shkretat.

Ai u skuq, por mbajti shpresë se pigmenti i lëkurës dhe mjekra, që kishte lënë, do ta fshihnin.

- Po... sepse unë korr lëndinat e tyre dhe kaq. Këtë kisha parasysh.

Vajza zbardhi dhëmbët.

- Pa shih, puna jote po shkuaka mirë e më mirë.

- Vafsh në djall.

Shumicën e herëve, ajo mjaftohej veç me një buzëqeshje dhe bënte ashtu siç i thoshin, me nxitimin e përhershëm për të mbërritur në auditor. Por sot, lëshoi një të qeshur të sforcuar dhe u kaloi dorën flokëve të saj të shkurtër ngjyrë rozë, nga skajet ku i kishte prerë brisku e gjer te kaçurrelat më të gjata majë kresë. Flokët e saj kishin qenë të zinj të premtën. Të kaltër muajin e kaluar. Të kuq ditën që ai kishte shtënë sytë mbi të, herën e parë.

Përpos, ai mbase lypsej të harxhonte më pak energji duke memorizuar ngjyrën që merrnin flokët e kësaj vajze dhe të shpenzonte më shumë në ... e dini vetë ju, në ato djallo gjëra të qenësishme. Nuk ishte se ai s'kishte gjësendi tjetër për të cilin të vriste - seminare pune ku lypsej të shkruante, synime të cilave duhej t'u kushtonte kohë, përfshirë aktivitetet jofitimprurëse, që kishin nevojë të merrnin udhë.

Por mandej vajza psherëtiu e atij iu shkëput sërish vëmendja nga logjika e fakteve.

- Kjo ishte psherëtimë për kokë të psherëtimës, - murmuriu ai, se e tillë kishte qenë.

- Doemos që po, - ia priti ajo e përhumbur. - Jam grua që s'më gjendet shoqja.

Boll e vërtetë, dhe një koment tipik i Danikës, por vështirimi i saj ishte i largët dhe ato fjalë dukej se nuk i